VENDIM
Nr.473, datë 23.6.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, për bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
MBI BASHKËPUNIMIN TREGTAR DHE EKONOMIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË SERBISË DHE MALIT TË ZI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Serbisë dhe Malit të Zi, më poshtë referuar si "Palë Kontraktuese",

duke marrë në konsideratë rëndësinë e marrëdhënieve tragtare dhe ekonomike midis Palëve Kontraktuese,

të shtyrë nga vullneti i përbashkët për zhvillimin e marrëdhënieve me interes të ndërsjellë dhe mirëkuptimit,

duke kuptuar nevojën e adoptimit të praktikave standarde të tregut ndërkombëtar dhe zgjerimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese do të nxisin, mbështesin dhe lehtësojnë zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet tyre në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ligjet e zbatueshme dhe normat e tyre.

Neni 2

Palët Kontraktuese, brenda përgjegjësisë së tyre, do të bëjnë përpjekje për të siguruar kushte të qëndrueshme për zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet tyre, duke u përqendruar në veçanti në bashkëpunimin ekonomik në fusha të tilla, si bankë, industri, teknikë, shkencë dhe teknologji.

Neni 3

Në lidhje me zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, Palët Kontraktuese do të nxisin shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit, veçanërisht lidhur me legjislacionin dhe programet ekonomike të tyre, si dhe çdo informacion tjetër me interes të ndërsjellë.

Neni 4

1. Të gjitha pagesat për mallrat e tregtuara ndërmjet personave juridikë dhe/ose fizikë (këtu më poshtë të referuara si ente) të dyja Palët Kontraktuese do t'i kryejnë në monedha lehtësisht të konvertueshme.

2. Në interes të lehtësimit të zhvillimit të bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik, Palët Kontraktuese nuk do të pengojë shkëmbimin e mallrave midis enteve të tyre në bazë të marrëveshjeve tregtare me kompesim, barter apo kontrata të tjera, në përputhje me normat logjore të tyre.

Neni 5

Palët Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe normat e tyre respektive, do t'i japin njëra-tjetrës ndihmë në organizimin e panaireve, ekspozitave të specializuara dhe aktiviteteve nxitëse.

Neni 6

1. Me qëllim zbatimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese kanë rënë dakord që të ngrenë një komision të përbashkët shqiptaro-serbomalazez të përbërë nga përfaqësues të të dyja Palëve Kontraktuese.

2.Komisioni i përbashkët do të takohet çdo vit, ose kur është e nevojshme, me kërkesë të ndonjërës Palë Kontraktuese, në mënyrë alternative në shtetet e secilës Palë Kontraktuese.

3. Me synim nxitjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet tyre, Komisioni i Përbashkët do të përqendrohet në sa më poshtë:

a) do të marrë parasysh rrugët dhe mënyrat për nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik ndërmjet Palëve Kontraktuese;

b) do të monitorojë progresin në zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe të përfunduara ndërmjet tyre lidhur me bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik dhe do të rekomandojë zgjidhje për probleme të cilat mund të kenë lindur nga zbatimi i këtyre marrëveshjeve;

c) do të identifikojë fushat për të kontribuar në zhvillimin e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik dhe do t'i paraqesë ato tek organet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese;

d) do të indentifikojë problemet që vështirësojnë bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik dypalësh dhe të rekomandojë masa për zgjidhjen e këtyre problemeve.

4. Komisioni i përbashkët mund të miratojë normat e veta procedurale.

Neni 7

Kjo marrëveshje nuk do të cenojë marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara dhe të zbatuara nga Palët Kontraktuese.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet me konsultime apo bisedime nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

1. Palët Kontraktuese do të kenë të drejtën të ndryshojnë çdo depozitë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo ndryshim ose dhënie fund e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e përfunduara ndërmjet enteve ekonomike të Palëve Kontraktuese gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj.

Neni 10

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë nga dita e marrjes së njoftimeve të fundit të

shkëmbyera nga Palët Kontraktuese që dëshmojnë se të gjitha kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj janë përmbushur.

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë 1 vjeçare e do të shtyhet automatikisht për një periudhë të mëtejshme njëvjeçare, nëse njëra prej Palëve-Kontraktuese nuk njofton me shkrim Palën tjetër Kontraktuese se i jep fund kësaj Marrëveshjeje. Në këtë rast Marrëveshja pushon së qeni në fuqi tre muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Beograd, më 23 maj 2005 në dy origjinale në gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht, me tekste njëlloj autentike. Në rast kontradikte në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.